



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228970

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474564

C. nr.110/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rr. "... të cilën e përfaqëson Kompania D... SH.P.K, rr..., Prishtinë, me autorizim F.J, kundër të paditurit E.Q nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 680.00 euro me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C.nr.110/18 e datës 15.03.2018, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rr. ..., kundër të paditurit E.Q nga Vushtrria, rruga ... me objekt kontesti rimbursim dëmi, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës).

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 15.03.2018, me bazë juridike rimbursim i dëmit në shumën prej 680.00 euro, kundër të paditurit E.Q nga Vushtrria, rruga ...

Gjykata me datë 19.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore, në të cilën ka konstatuar se paditësja B... ka paraqitur dy padi të njëjta, kundër të paditurit të njëjtë-E.Q, përkatësisht lënda C.nr.110/18 sipas padisë së datës 15.03.2018, me të cilën kërkohet shuma prej 274 euro, prej paditëses tek i padituri E.Q në emër të kompensimit të dëmit të dëmtuarit F.C, e po ashtu edhe në lëndën C.nr.227/18 sipas padisë së datës 18.05.2018, kërkohet shuma e njëjtë prej 274 euro, ndërsa përfaqësuesi i paditëses deklaroi se shuma totale në emër të rimbursimit që duhet të

paguhet nga i padituri është 544 euro dhe atë për të dëmtuarin F.C shumën prej 274 euro, ndërsa për të dëmtuarin M.S shumën prej 270 euro, ndërsa nuk kanë kërkesa për të dëmtuar të tjerë.

Gjykata pasi analizojë të dy lëndët C. nr. 110/18 dhe C. nr. 227/18, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispendencës.

Nga të cekurat më lartë gjykata duke u bazuar në nenin 391 pika c) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr.110/18, me datë 19.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.